

Statistikat e kulturës

Tremujori IV – 2018

Tiranë, më 1 Shkurt 2019: Numri i shfaqjeve kulturore në tremujorin e katërt 2018 është 346, duke shënuar një rritje me 3,3 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017. Në vitin 2018, numri i shfaqjeve/ekspozitave është 1.011, duke patur një rritje me 21,7 %, në krahasim me 2017.

Në tremujorin e katërt 2018 numri i spektatorëve është 69.565, duke pësuar ulje me 31,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i spektatorëve në vitin 2018 është 212.380, duke patur ulje prej 2,0 %, krahasuar me 2017.

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e katërt 2018 është 201 spektatorë/vizitorë për shfaqje dhe ka pësuar ulje me 33,8 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017.

Për vitin 2018 pjesëmarrja mesatare ka pësuar një ulje me 19,4 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve / ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Viti 2017	Viti 2018	Ndryshimi vjetor në %	Tr.4-2017	Tr.4-2018	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	143	156	9,1	56	61	8,9
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	99	97	-2,0	61	31	-49,2
Teatri Kombëtar Eksperimental	320	457	42,8	132	173	31,1
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	65	55	-15,4	20	10	-50,0
Galeria Kombëtare e Arteve	17	3	-82,4	7	1	-85,7
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	187	243	29,9	59	70	18,6
Shfaqje kulturore/ekspozita gjithsej	831	1.011	21,7	335	346	3,3

Në tremujorin e katërt 2018, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve, me 173 të tilla, duke shënuar rritje prej 31,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Galeria Kombëtare e Arteve ka patur numrin më të vogël të ekspozitave, me vetëm një të tillë, për tremujorin e katërt 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kur kishte 7 ekspozita.

Në vitin 2018, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, me 457 shfaqje, duke patur rritje prej 42,8 %, krahasuar me periudhën e mëparshme. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë renditet e dyta për numrin më të lartë të shfaqjeve/ekspozitave, me 243 të tilla të realizuara për vitin 2018, duke patur një rritje prej 29,9 %, krahasuar me vitin 2017.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve / vizitorëve në institucionet kulturore


Numri i spektatorëve vizitorëve/audiencia	Viti 2017	Viti 2018	Ndryshimi vjetor në %	Tr.4-2017	Tr.4-2018	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	48.390	39.503	-18,4	19.888	10.959	-44,9
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor	57.055	54.438	-4,6	28.000	24.873	-11,2
Teatri Kombëtar Eksperimental	43.569	65.989	51,5	17.389	19.892	14,4
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	2.530	3.449	36,3	960	886	-7,7
Galeria Kombëtare e Arteve	38.738	19.776	-48,9	27.123	3.847	-85,8
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	26.424	29.225	10,6	8.353	9.108	9,0
Numri i spektatorëve/vizitorëve gjithsej	216.706	212.380	-2,0	101.713	69.565	-31,6

Në tremujorin e katërt 2018, Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansambilit Popullor ka patur 24.873 spektatorëve/vizitorëve, duke shënuar një rënie prej 11,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Rritjen më të lartë në përqindje për numrin e vizitorëve/spektatorëve, në tremujorin e katërt 2018 e ka shënuar Teatri Kombëtar Eksperimental me 14,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në vitin 2018, Teatri Kombëtar Eksperimental ka patur 65.989 spektatorëve/vizitorëve duke shënuar rritje prej 51,5 %, krahasuar me vitin 2017.

Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje/ekspozitë



Numri mesatar i vizitorëve/spektatorëve për shfaqje/ekspozitë në tremujorin katërt 2018 është 201, duke shënuar ulje me 33,8 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017

Në vitin 2018, numri mesatar i vizitorëve/spektatorëve për shfaqje/ekspozitë ka patur rënie në 210, duke u ulur me 19,4 %, krahasuar me vitin 2017

Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Numri i vizitorëve	Viti 2017	Viti 2018	Ndryshimi vjetor në %	Tr.4-2017	Tr.4-2018	Ndryshimi tremujor në %
Muze	200.986	301.861	50,2	52.805	58.281	10,4
Kala e Monumente të tjera	201.148	308.656	53,4	27.506	38.423	39,7
Parqe Arkeologjike	260.888	377.835	44,8	29.650	37.026	24,9
Numri i vizitorëve gjithsej	663.022	988.352	49,1	109.961	133.730	21,6

Numri i vizitorëve në muze, në tremujorin e katërt 2018 është 58.281, duke shënuar rritje me 10,4 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017.

Në kala e monumente të tjera, në tremujorin e katërt 2018, numri i vizitorëve është rritur me 39,7 %, krahasuar me të njëjtit tremujor në vitin 2017.

Numri i vizitorëve në parqe arkeologjike, në tremujorin e katërt 2018 është 37.026, me rritje prej 24,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë, të vitit të mëparshëm.

Numri i vizitorëve në muze, kala e monumente të tjera, si dhe në parqe arkeologjike, për vitin 2018 është 988.352, duke shënuar rritje me 49,1 %, krahasuar me vitin 2017.

Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare

Treguesit	Viti 2017	Viti 2018	Ndryshimi vjetor në %	Tr.4-2017	Tr.4-2018	Ndryshimi tremujor në %
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	110.605	89.212	-19,3	24.941	26.483	6,2
Frekuentimi	123.703	82.414	-33,4	32.150	23.819	-25,9
Numri i botimeve	16.511	14.186	-14,1	5.464	5.186	-5,1
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	3.243	2.895	-10,7	1.046	1.031	-1,4
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	13.268	11.291	-14,9	4.418	4.155	-6,0

Në tremujorin e katërt 2018, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 5.186 botime, 5,1 % më pak, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017. Nga këto botime 1.031 ishin tituj të rinj dhe 4.155 ekzemplarë të rinj.

Numri i botimeve për vitin 2018 është 14,186, duke shënuar rënie me 14,1 %, krahasuar me vitin 2017. Nga këto botime 2.895 ishin tituj të rinj dhe 11.291 ekzemplarë të rinj.

Shënime metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala. Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.